



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 19-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 29. 06. 2015 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Nehat Tërpeza, anëtar
3. Daut Azemi , anëtar
4. Agron Hajdini, anëtar
5. Arton Retkoceri, anëtar
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Burbuqe Fazliu, anëtar
8. Linda Shahini, anëtar
9. Xhevat Olluri, anëtar
10. Rizah Bajraktari, anëtar
11. Ukë Kryeziu, anëtar
12. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
13. Hajrije Salihu, anëtar
14. Blerim Gashi, anëtar
15. Adelina Krasniqi, anëtar
16. Florent Hoxha, anëtar
17. Petrit Kelmendi, anëtar
18. Ragip Zejnullahu, anëtar
19. Nazmi Krasniqi anëtar
20. Enver Kozhani, anëtar
21. Feriz Hasani, anëtar
22. Ali Stublla, anëtar
23. Valbona Shillova, anëtar
24. Burbuqe Ilazi, anëtar
25. Vlora Buja, anëtar
26. Arben Bahtiri, anëtar
27. Edita Gashi, anëtar
28. Ramiz Qeriqi, anëtar
29. Zoran Çirkovic anëtar
30. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës
3. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
4. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF
5. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
6. Basri Hashani, Drejtor i DKRS
7. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
8. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës
9. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
10. Avni Olluri, Drejtor i DGJK
11. Feti Krasniqi,
12. Remzi Mehmeti,
13. Ilir Tasholli,
14. Vlora Krasniqi, zyra ligjore
15. Qëndresa Jashanica,
16. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
17. Bekim Krasniqi, "YAGR"
18. Bukuriye Zejnullahu, zyra për informim
19. Përfaqësuesit e mediave
20. Numër i konsideruar i qytetarëve

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë, a ka dikush vërejtje apo plotësime.

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë ,Kryesuesja e Kuvendit, vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota miratoi këtë :

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 17-të dhe 18-të e jashtëzakonshme e KK-së
2. Propozim Vendim mbi aprovimin e Kornizës afatmesme buxhetore 2016-2018
3. Propozim Rregullore për detyrat e punës, obligimet, përgjegjësit dhe masat disiplinore të personelit të institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit.
4. Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për disiplinën dhe mirësjelljen në shkollat e Komunës së Lipjanit 1Nr.116-724 e datës 20. 07. 2010
5. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan.

Pas aprovimit të rendit të ditës Kryesuesja e Kuvendit pyeti anëtarët se a ka dikush të shtoj diçka para se të kalojmë në punë sipas rendin të ditës.

Ali Stublla, meqë janë duke u mbajtur zgjedhjet nëpër fshatra dhe lagja jonë nuk e dijmë se a jemi me Lipjan apo ku jemi është mirë që dikush të na sqarojë këtë.

Nazmi Krasniqi, edhe më heret e kam cek se kontinjerët nëntokësor nuk janë funksional dhe është premtu se së shpejti do të funksionalizohen e gjithashtu në Qytet mungon ndriqimi në disa rrugë.

Agron Hajdini, unë po e ngriti një shqetësim të qytetarëve ku në mes të objektit Urban Center dhe Marigonës është hap një grop dhe është rrezik për qytetarët dhe kanë kërkuar që të mbyllet apo të rrethohet ajo gropë.

Enver Kozhani, në Ribarë të Madh janë duke u bërë matjet për asfaltimin e disa rrugëve por te lagja Rama kjo rrugë është lënë anash dhe para dy muajve Kryetari ka deklaruar se nuk do të shtrojë rrugë të vëllazërve e kjo po ndodh. Unë kam bisedu me Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe tenderi ende nuk është shpall për këtë rrugë dhe kërkoj që edhe rruga e lagjes Rama të përfshihet meqë ata janë anashkaluar edhe për kanalizim.

Në fshatin Kraishtë banorët kanë shqetësim për shkak të mbylljes së kanalizimit ku ujërat e zeza kanë dalë mbi sipërfaqën e tokësore dhe kërkojnë që të rregullohet kanalizimi meqë është i pa përballueshëm kundërmimi dhe është rrezik për ndonjë epidemi.

Ramiz Qeriqi, shprehi shqetësimin e prindërve për semimaturantët meqë është folë se nuk do të ket mbrëmje të maturës dhe në Lipjan është organizu mbrëmja e maturës dhe nxënësit kanë paguar kurse mbrëmja nuk është mbajtur e nuk e di se a është fajtor Drejtori apo dikush tjetër për këtë qështje. E dyta te provimi i maturës për nxënësit ka qenë një lojë meqë provimi kishte qenë i varur prej arsimtarit që ka qenë në klasë meqë në disa klasë ua kanë marrë edhe telefonat a në disa klasë tjera u kanë thënë vetëm mos bani zhurëm dhe kopjoni sa të mundni.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha po përpiqem me ju përgjigj pyetjeve të juaja.

Për fshatin Topliqan i Ri po ju them nuk e di a është e vërtetë se ky është një fshat më i madh se disa fshatra dhe për të ardhmen do ta kemi parasysh për zgjidhjen e kësaj qështje.

Te ndriqimi publik është e vërtetë se mungon por për një moment është bërë edhe mirë dhe pyes se a kanë mundësi qytetarët e Lipjanit të paguajnë 8 -10 mijë euro për ndriqim, por sido që të jetë ne do ta zgjidhim edhe këtë problem.

Te rrugët që përmendi Enveri unë jam i vetëdijshëm se nuk mund të përfshihen të gjitha rrugët dhe ju garantoj se asnjë rrugë private(vllaznillakut) nuk do të shtrohet.

Për kanalizimet nuk janë problemet vetëm në Kraishtë por edhe në vendet tjera se janë punuar keq e tani na po ballafaqohem me këto probleme.

Te semimaturantët kemi pas takim dhe jemi pajtu të gjithë që mos të mbahet mbrëmje sikurse është mbajtur vetëm deri në ora 8 në mbrëmje të mbahet ndonjë koktej. Në Lipjan ka ndodh kjo është mbajtur mbrëmja.

Sa i përket testit të maturës këtë nuk e organizojmë na meqë është kompetencë e Ministrisë por një organizim ka qenë edhe nga DKA-ja.

Merita Zeqiri-Hajrizi, është e vërtetë që në një takim me arsimtar Kryetari i Komunës ka thënë se nuk ka mbrëmje të maturës për semimaturant por mund të organizohet një koktej-ceremoni me pelqimin e prindërve të nxënësve dhe shkolla jonë "Ismajl Luma" ka organizu këtë koktej dhe marveshtja ka qenë prej orës 16 por për shkak të vapës së madhe në sallën e shkollës këtë koktej e kemi shty për në ora 18 dhe Drejtori i shkollës e ka ftuar Drejtorin e DKA-së për ta njoftuar për këtë por nuk e ka hapur telefoni për shkak se kishte qenë i nxanun, kështu që ne koktejin e kemi fillu në ora 18-të në ora 20 ka interveni policia për ndërprerjen e këtij kokteji dhe falë nxënësve nuk ka ndodh asnjë ekces por nxënësit nuk janë ndarë të kënaqur dhe ne nuk e dijmë se kush ka intervenu te policia.

Pasi qështje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I
Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 17-të e radhës dhe e 18-të e jashtëzakonshme e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 17-të dhe 18-të të Kuvendit?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, Kryesuesja vuri në votim ekstraktet dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi

Aprovoi
Ekstraktet nga procesverbali i mbledhjes së 17-të dhe 18-të të Kuvendit pa vërejtje

Shtesë: Ekstrakti.

II
Propozim Vendim mbi aprovimin e Kornizës afatmesme buxhetore 2016-2018

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Shkelzen Hajdini Drejtor i DBF-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me procedurat e hartimit të kornizës buxhetore duke shtuar se kjo kornizë është hartu në bazë të qarkorës së parë buxhetore me të cilën është caktu tavani për kategoritë buxhetore. Në vazhdim përmes kinoprojektorit njoftoi të pranishmit me propozim Vendimin dhe kornizën buxhetore të cilat janë pjesë përbërse të procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Agron Hajdini, hartimi i kornizës buxhetore është obligim i Komunës që qdo vit të harton kornizën afatmesme buxhetore. Kur është fjala te shpenzimet që janë parapa për vitet vijuese nga të hyrat vetanake mendoj se është një ndarje reale dhe parimisht duhet ta përkrahim. Te investimet kapitale mendoj se janë përfshi të gjitha rajonet e komunës.

Petrit Kelmendi, unë edhe në KPF kam pasur tri kërkesa që të përfshihen në këtë kornizë buxhetore.

1. E para që të përfshihen zonat industriale
2. E dyta të parashihet projekti për rregullimin e shtratit të lumit "Sitnica" dhe
3. E treta të rriten subvencionet për bujqësi.

Florent Hoxha, na si grup parlamentar i PDK- së e kemi shqyrtu kornizën buxhetore dhe në bazë të planifikimit shihet se planifikimi i projekteve është bërë në baza politike dhe nuk është gjithë përfshirës meqë kemi zona që prej pas luftës nuk është bërë asnjë investim si shembull po e marr te fshati Divjakë dhe buxheti që ka qenë i paraparë për rrugën e këtij fshati në shumë prej 100 mijë euro Drejtori ka deklaruar se janë marrë këto mjete. Në vazhdim tha se për këtë kornizë buxhetore do të ketë edhe debate publike se në KPF, shoqëria civile dhe grupe tjera të interesit. Sa i përket shifrave që i paraqiti Drejtori na e dijmë se disa shifra vijnë nga niveli qëndror dhe na nuk mund t'i ndryshojmë. Pastaj tha se në këtë vit kemi rënje në realizimin e të hyrave vetanake.

Te investimet kapitale në Drejtoratin e Shërbimeve Publike është paraparë mirëmbajtja e rrugëve dhe është përfshi si tërësi dhe nuk janë specifiku se cilat rrugë, andaj

është mirë të thuhet se cilat rrugë do të mirëmbahen. Te rruga e Smallushës ka dhënë vërejtje Nazi dhe kërkojmë të dihet se kjo rrugë a është për fshatin Smallushë apo e Sllovisë.

Gjithashtu kërkoj që te trotuarët të cekën se për cilat fshatra do të ndërtohen trotualet.

Për fshatin Mirenë është mirë që është planifiku shkolla meqë ky fshat ka nevojë për një shkollë të re.

E përmendi edhe Petriti për zonat ekonomike dhe duhet t'u japim rëndësi të veçantë këtyre zonave meqë me ndertimin e tyre do të krijohen kushte për punësim dhe rritja e të hyrave.

Xhevat Olluri, jemi duke shqyrtuar një pikë të rëndësishme e cila ka ndikim në të gjitha degët e jetës. Është koha që të bisedojmë se çka është prioritarë për zhvillimin ekonomik, infrastrukturën etj. Unë mendoj se nuk ka zhvillim pa ngritjen e cilësisë në arsim, andaj mendoj se investimet kapitale në lëminë e arsimit për vitet e ardhshme duhet të rriten. Në vazhdim propozoj që për fshatrat e largëta larg qendres të parashihet ndërtimi i rrugëve shembull siqë është fshati Plitkoviq në mënyrë që ato fshatra të kenë mundësi të zhvillojnë ekonominë e tyre familjare dhe mos të shpërngulen.

Në qytet propozoj që të ndërtohen staza për biçikleta.

Ramiz Qeriqi, te asfaltimi i rrugëve në Lipjan kërkoj që të caktohen se cilat rrugë janë në prioritet. Te shkollat propozoj që të hiqet nxemja me dru dhe të bëhen me derivate tjera. Te stadiumi "Ulpiana" duhet të thuhet sakt stadiumi i qytetit "Sami Kelmendi". Te renovimi i shkollës në Krojmir propozoj që së pari të bëhet renovimi e pastaj nxemja. Për mbylljen e kanalizimeve që përmendi Florenti unë ju njoftoj se në lagjen time është mbyll kanalizimi dhe fajtor për mbyllje të kanalizimit është kompania që e ka punuar këtë kanalizim.

Nazmi Krasniqi, unë pajtohem me propozimin e Xhavitit për investime më të mëdha në arsim meqë dihet se në arsim mungon kuadri arsimor dhe një numër i konsideruar i profesorëve janë të moshuar. Te testi i maturës dhashtë zoti të jetë real por unë dyshoj shumë se një testë po kopjohet.

Për planifikimin e rrugës në Smallushë unë nuk e di se kjo rrugë a është për Smallushë apo është rruga e Sllovisë që e lidhë lagjen e poturëve.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, kjo rrugë që e ceki Nazi është te lagja e poturëve e disa i thonë Smallushë e disa Sllovi. U tha se është buxhet selektiv apo politik dhe unë ju them se apsolutisht nuk qëndron. Në vazhdim njoftoj lidhur me shpalljen e tendereve për asfatimin e rrugëve, borxhet e fakturave që janë edhe 1 milion euro.

Asnjëherë nuk është investu më shumë në arsim se sa tani dhe dihet se në shumë shkolla duhet të ndërrohen kulmet e tyre se janë punuar keq dhe tani ne po merremi me pasojat.

Pastaj tha se rrjetin e kanalizimeve të Bujarisë, Qallapekut, Llugaxhisë e kemi shpallë tenderin dhe do të hyjnë në një kanalizim deri te Sitnica. Xhevati propozoj për ndërtimin e rrugës për fshatin Plitkoviq dhe ju njoftoj se personalisht e kam vizitu dhe ju pyes se a thoni ju që ta hjekim një projekt dhe ta asfaltojmë rrugën e Plitkoviqit për dy familje. Për stazat për biçikleta a kemi na lluks me e hjek ndonjë projekt e me bërë stazat e biçikletave dhe unë mendoj se më mirë është të bëjmë nxemjet nëpër shkolla se sa stazat për biçikleta.

Merita Zeqiri- Hajrizi, propozoj që me këtë kornizë buxhetore të parashihet rrethoja e shkollës fillore "Vllëzërit Frashëri" meqë në oborrin e shkollës është ndërtuar edhe parku dhe ka probleme me ngatërresa të nxënësve, andaj kjo rrethoj do ta ndante parkun me oborrin e shkollës.

Për fshatin Hallaq i Madh e pash në prioritet asfaltimin e rrugicave por aty nuk ka rrugica por vetëm një rrugë që e lidh Hallaqin e Madh me Ruzicën e Ri dhe unë mendoj se në

prioritet duhet të jetë trotuarët në fshatin Hallaq i Madhe dhe prej Hallaqit të Madh në Hallaq të Vogël. Kanalizimi në Hallaq të Madh nuk është funksional dhe duhet të intervenohet.

Blerim Gashi, kjo është kornizë dhe diskutimet që po bëhen nuk konsistojnë me këtë kornizë. Pastaj tha se kjo kornizë del në diskutim publik dhe aty mund t'i japim propozimet.

Pastaj tha se duhet të kërkohet nga Qeveria zvogëlimin e tavanit të të hyrave vetanake. Në fund parashtroj pyetje për Drejtorin e arsimit se a i ka parapa mjetet me buxhet për shujtjet e arsimtarëve?

Me që diskutime të tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja, vuri në votim propozim Vendimin dhe kornizën buxhetore me propozimin që te rruga e Smallushës të thuhet rruga që lldh Sllovinë me lagjen e Poturëve dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 19 vota për 9 kundër miratoi këtë:

VENDIM

MBI APROVIMIN E KORNIZES AFATMESME BUXHETORE 2016-2018

Neni 1.

Me këtë Vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2016-2018 për Komunën e Lipjanit

Neni 2.

Me , Kornizën Afatmesme Buxhetore 2016-2018 do të financohet:

FONDI BURIMOR	VITI 2016	VITI 2017	VITI 2018
Grant i Përgjithshëm	4,221,055.00	4,302,395.00	4,399,183.00
Grant Specifik i Arsimit	5,710,828.00	5,710,828.00	5,710,828.00
Grant Specifik i Shëndetësisë	1,361,955.00	1,361,955.00	1,361,955.00
Të hyrat vetanake	1,850,000.00	1,870,000.00	1,890,000.00
TOTALI	13,143,838.00	13,245,178.00	13,361,966.00

Neni 3.

Mjetet nga neni 2.i këtij Vendimi do shpërdahen në kategorit ekonomike si vijon:

KATEGORITE EKONOMIKE	VITI 2016	VITI 2017	VITI 2018
Paga e Mëditje	9,065,959.00	9,065,959.00	9,065,959.00
Mallra dhe Shërbime	894,697.00	894,697.00	894,697.00
Shërbime Komunale(Komunalit)	188,390.00	188,390.00	188,390.00
Subvencione dhe Transfere	161,000.00	161,000.00	161,000.00
Investimet Kapitale	2,833,792.00	2,935,132.00	3,051,920.00
TOTALI	13,143,838.00	13,245,178.00	13,361,966.00

Neni 4.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Neni 6.

Me këtë Vendim të njoftohet Ministria e Financave, MAPL dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë : Vendimi.

III

Propozim Rregullore për detyrat e punës, obligimet, përgjegjësit dhe masat disiplinore të personelit të institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Rasim Hasanit Drejtor i DKA-së i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me procedurat e hartimit të kësaj Rregullore dhe më pastaj njoftoi me të dhënat nga propozimi i Rregullores e cila është pjesë përbërëse e procesverbalit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Nehat Tërpeza, kjo Rregullore është shqyrtu edhe në Komitetin për arsim e gjithashtu edhe në grupin parlamentar të LDK-së dhe është vlerësim se ky ekzekutiv ka casje serioze ndaj institucioneve arsimore. Na si grup parlamentar i LDK-së e mbështesim këtë Rregullore me rekomandimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport që nenit 7 t'i shtohet edhe një pikë dhe të thuhet mësimdhënësit janë të obliguar të mbajnë uniformat, pastaj kjo përgjegjësi t'i shtohet si pikë e veçant drejtorave të shkollave. Gjithashtu nga kjo Rregullore të zbatohen edhe masat disiplinore pasi në disa shkolla përgjegjësia është e mangët.

Shërbimi profesional i shkollave siqë janë pedagogët dhe psikologët është vlerësim që shkollat t'i kenë pedagogët dhe psikologët.

Merita Zeqiri-Hajrizi, unë i them Nehatit se uniforma e mësimdhënësve nuk përkon me kodin e veshjes ka të bëjë me gjëra tjera. Sa i përket shërbimeve profesionale në shkolla kisha me pyet se ku pretendoni të ketë pedagog dhe psikolog meqë shkollat e Lipjanit nuk kanë as pedagog e as psikolog.

Hajrije Salihu, unë e kam lexuar këtë Rregullore dhe ja vlenë që të nxirret një Rregullore e tillë por te neni 6 e kësaj Rregullore janë përmend detyrat dhe përgjegjësit e shërbimit profesional të shkollës, shërbimi pedagogjik, psikologjik (pedagogu, psikologu, sociologu) a dihet se në shkollat tona nuk kemi pedagog as psikolog. Gjithashtu te neni 7 pika 7.18 thuhet mësimdhënësit nuk ju lejohet marrja e të hollave nga nxënësit që sipas meje është e pa kurtë dhe kërkoj që të sqarohet. Te ora e kujdestarisë që është parapa propozoj që kjo të hyn në normën e orëve dhe të parashihet pagesa.

Arben Bahtiri, kjo Rregullore ka për objekt përcaktimin e rregullave për funksionimin e brendshëm të shkollave. Unë e mbështes këtë Rregullore meqë kjo Rregullore ndalon mbajtjen e kurseve brenda dhe jasht institucioneve arsimore. Gjithashtu propozoj që përveq masave disiplinore të ket edhe shpërblime.

Xhevat Olluri, te neni 6 ku janë të para përgjegjësitë e shërbimit profesional – shërbimit pedagogjik a dihet se na nuk i kemi këto shërbime por e kemi kordinatorin për zbatimin e korikulës që është emëruar nga Drejtori. Te neni 7 është thënë se ndalohe

profesorëve marrja e të hollave nga nxënësit, por profesorët marrin të holla nga nxënësit për diftesat, diplomat apo për ndonjë fotokopje kur shkolla nuk ka mundësi me i bërë ato. Te neni 17 është thënë ndalohet mbajtja e telefonit që sipas mendimit tim kjo nuk është në rregull por duhet të thuhet nuk kanë të drejtë përdorimin e telefonit. Te ora e kujdestarisë duhet të parashihet në normën e orëve.

Vlora Limani-Hajnuni, pat shumë propozime që dhe profesori Xhevat dhe unë kam thënë edhe më heret që të respektohet Rregullorja e punës së Kuvendit se në këtë mënyrë të propozimeve unë nuk mund të shenoj të gjitha propozimet.

Nazmi Krasniqi, kësaj Rregullore i ka munguar debati në shkolla dhe në këtë Rregullore janë bërë duplikime me Ligjin dhe ato që i rregullon Ligji nuk ka pasur nevojë të parashihen në Rregullore. Uniforma për nxënës është obligative, kurse për profesora nuk e di. Ora e kujdestarisë është hequr nga pagesa meqë në tërë Kosovën ka kushtuar 2 milion euro dhe për shkak të mjeteve është hequr. Qështja e pedagogëve është e rregulluar me Ligj dhe Banka Botërore ka lejuar vetëm 2 pedagog në Drejtorat. Sa i përket kuadrit në Komunën e Lipjanit mungojnë mësuesit e klasës dhe mësues të klasës janë pedagogët, historianët etj.

Sa i përket zgjedhjes së kuadrit arsimor në shkolla kjo është bërë në suaza të politikës.

Rasim Hasani, Drejtor i DKA-së, unë nuk kam thënë kjo Rregullore do ta ngris cilësinë në arsim por kam thënë do të ndikoj dhe fjala ngris - ndikoj janë të ndryshme. Sa i përket uniformës unë e kam thënë edhe në KPF se uniforma për nxënës është obligative e këtu kemi të bëjmë për uniformën për arsimtar dhe profesor. Për telefonat që e përmendi profesori Xhevat vërejtja është me vend dhe të ndryshohet e thuhet ndalohet përdorimi i telefonave në orë.

Ora e kujdestarisë konsideroj se gjithëmonë gjenden mundësitë për mbajtjen e saj.

Te ndalimi i marrjes së tëhollave nga profesorët këtë e kemi propozu meqë pagesat për diploma, dëftesa dhe aktivitete të ndryshme duhet të bëhen nga prindërit.

Vlora Limani-Hajnuni, u përmend nga Nehati dhe mua faktikisht nuk më pelqen uniforma që është sot meqë është si për punëtorët teknik apo sherbyesve civil nëpër shkolla dhe për uniformën propozoj që të respektohet kodi i veshjes. Në vazhdim propozoj ndryshimet sipas propozimeve për këtë Rregullore si vijon:

Te neni 3 te detyrat dhe përgjegjësit e Drejtorit të shkollës të shtohet pika 3.8 dhe të thuhet Drejtori kujdeset për respektimin e kodit të veshjes nga personeli arsimor e cila veshje duhet të jetë e ngjashme kodin e veshjes së shërbyesve civil.

Te neni 7 pika 7.25 mësimdhënësi të respektoj kodin e veshjes që duhet të jetë i ngjajshëm me kodin e veshjes së shërbyesve civil.

Te neni 11 pika 11.6 ku thuhet të njoh mirë psikologjinë, veqoritë interesat dhe prirjet e secilit nxënës të klasës të thuhet:

Të përcjell gjendjen psiko fizike, veqoritë, interesat dhe prirjet e secilit nxënës të klasës.

Te neni 17.11 të thuhet ndalohet përdorimi i telefonit celular gjatë orës mësimore.

Pastaj Kryesuesja vuri në votim propozimin e Rregullores me propozimet për ndryshim të cekura më lartë dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për 1 apstenim miratoi:

Rregullore për detyrat e punës, obligimet, përgjegjësit dhe masat disiplinore të personelit të institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit.

Shtesë: Rregullorja

Në ora 13,00 Kryesuesja dha pauzë deri në ora 14,30
Pas pauzës në ora 14,45 Kuvendi vazhdoi punën sipas pikës së katër.

IV

Propozim Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për disiplinën dhe mirësjelljen në shkollat e Komunës së Lipjanit 1Nr.116-724 e datës 20. 07. 2010

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Rasim Hasanit Drejtor i DKA-së i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Nehat Tërpeza, tha se këtë Rregullore e kemi shqyrtu edhe në grupin parlamentar të LDK-së edhe në Komitetin për arsim dhe ne si LDK e përkrahim këtë propozim Rregullore.

Florent Hoxha, na edhe më heret tham se pas aprovimit të Rregullores paraprake pa tjetër duhet ndryshuar edhe kjo Rregullore, andaj edhe ne si grup parlamentar i PDK-se e përkrahim këtë Rregullore.

Meqë diskutimet tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Rregullores dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për asnjë kundër 2 apstenime miratoi këtë:

Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për disiplinën dhe mirësjelljen në shkollat e Komunës së Lipjanit 1Nr.116-724 e datës 20. 07. 2010

Shtesë: Rregullore.

V

Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Fauz Xhemajlit Drejtor i DKA-së i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Enver Kozhani, na si grup parlamentar i PDK-se e mbështesim këtë propozim Vendim.

Daut Azemi, unë më heret kam propozu që për këto vendime ta autorizojmë Kryetarin por propozimi i im nuk ka kaluar andaj edhe ne si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim këtë propozim Vendim.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se me 25 për kundër nuk pati as apstenim miratoi këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË
ISLAME NË LIPJAN

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej 3520 €, (tre mijë e pesëqind e njëzet euro), për subvencionim të shpenzimeve të varrimeve, për 32 raste të vdekjes të cilat kanë ndodhur prej datës 15.04.2015 deri më 01.06.2015 me nga 110 Euro për secilin rast $110 \times 32 = 3520$.

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2015.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 15,⁰⁰

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni